



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ”
GJIROKASTËR
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE**

**PAKETA E PRAKTIKËS
MËSIMORE/PROFESIONALE
FESHSH**

- 1. Programet e ciklit të parë të studimit “Bachelor”**
- 2. Programet e ciklit të dytë të studimit “Master”/ “Master Profesional”**
- 3. Programet e studimit me karakter profesional**

Gjirokastër, shtator 2020





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE
NJËSIA BAZË E EDUKIMIT DHE METODOLOGJISË SË MËSIMDHËNIES
Gjirokastër, më 06.10.2020

MIRATOI
DEKANI
Prof.dr.Gëzim SALA



RREGULLORE E PRAKTIKËS PROFESIONALE TË STUDENTËVE QË JANË PJESË
E PROGRAMEVE TË STUDIMIT NË NJËSINË BAZË TË EDUKIMIT DHE
METODOLOGJISË SË MËSIMDHËNIES.

(Kjo rregullore është mbështetur në Paketën e praktikës mësimore/profesionale të FESHSH)

Praktika profesionale është pjesë përbërëse dhe shumë e rëndësishme e programeve të studimit në Njësinë Bazë të Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies (NJBEMM). Praktika profesionale, bazohet në lidhjen e ngushtë midis universitetit, pushtetit vendor, institucioneve arsimore dhe shkollave të Sistemit Parauniversitar, në Republikën e Shqipërisë, si partnerë bazë.

Kjo periudhë e studimeve është një moment i rëndësishëm në përfitimin e përvojave të para arsimore të studentët. Praktika profesionale është pjesë e çdo programi studimi në NJBEMM-së.

Shtrirja e saj në çdo program studimi është si më poshtë:

Nr.	Programi i studimit	Emërtimi praktikës	I	Javët	ECTS	Viti	Semestri
1.	"Bachelor" në "Mësuesi i Arsimit Fillor KL.1-5	Praktikë profesionale: Pasive		3 javë	13	I tretë	I



		Praktikë profesionale:Aktive	3 javë		I tretë	II
2.	“Bachelor” në “Mësuesi i Arsimit Fillor KL.1-5	Praktikë profesionale: Pasive	3 javë	13	I tretë	I
		Praktikë profesionale:Aktive	3 javë		I tretë	II
3.	Program studimi 2-vjeçar me karakter profesional “Edukatorë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme (0-3 vjeç)”	Praktikë profesionale	15 javë	30	I dytë	II
4.	Master Profesional në “Mësuesi Ndhmës në Edukimin Gjithëpërfshirës”	Praktikë profesionale	3 javë	6	I	II
5.	Master Profesional në “Mësuesi i Arsimit Fillor klasa 1-5”	Praktikë profesionale	3 javë	6	I	II

Qëllimi i praktikës është aftësimi profesional i studentëve nëpërmjet praktikës në institucionet shkollore, parashkollore dhe EZHFH. Nëpërmjet saj studenti, do të zhvillojë shprehitë bazë të mësimdhënies, kuptimin e qartë për institucionet shkollore dhe vendin e saj në komunitet, inkurajon analizën kritike dhe reflektimin e përvojës dhe problemeve që ngrihen në shkollë nga format e ndryshme të organizimit të punës dhe inkurajon zhvillimin e një qëndrimi profesional ndaj cilësive të mësuesit. Rol të rëndësishëm në këtë periudhë, luan ndihma e mësuesve mentor të kualifikuar, mësuesve ndihmës, drejtorëve të shkollës, drejtuesit të institucioneve për edukimin e fëmijërisë së hershme, të cilët i ndihmojnë studentët me karakteristikën e çdo fëmije, evidentimin e nevojave që kanë ata, mënyrën si organizojnë ditën mësimore. Gjatë praktikës profesionale, studentët do të njohin aspektet dhe problematikat e punës me fëmijët, familjet dhe profesionistët. Një praktikë e mirë i pajisë studentët me njohuri për karrierë dhe krijon përvojë reale për kërkesat e përditshme të profesionit që kanë zgjedhur. Kjo do të thotë se studentët do të jenë më të përgatitur për tu hedhur në tregun e punës. Studentët do të zhvillojnë një sërë aftësish komunikuese dhe praktike. Ato kanë lidhje të drejtpërdrejtë me formimin e tyre, me zhvillimin profesional dhe me ushtrimin e profesionit.

Gjatë zhvillimit të praktikës profesionale studenti duhet:

- Të praktikojë teknika dhe metoda me efektivitet dhe të sigurojë të nxënë produktiv tek nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies.
- Të përdorë teknika mësimdhënie që të nxiti të mësuarit me në qendër nxënësin.
- Të krijojë situata argëtuese me fëmijët, duke përfshirë emocionet pozitive tek çdo fëmijë
- Të organizojë aktivitete individuale dhe grupi, duke rritur besimin e fëmijëve në aftësitë e tyre.
- Të vlerësojë nevojat dhe interesat e nxënësve, duke edukuar tek ata vlera të edukimit



qytetar demokratik.

- Të vlerësojë sistematikisht dhe të krijojë një sistem rigoroz të përparimit të nxënësve.
- Të analizojë mësimdhënien e tij/e saj për të përmirësuar komponentët e mësimdhënies gjatë veprimtarisë aktive në klasë.
- Të zotërojë aftësi dhe kompetenca për të kaluar të gjitha barrierat që do të hasi në lidhje me problematikat që do të kenë fëmijët me vështirësi në të nxënë.

Fazat e zhvillimit të praktikës

Praktika profesionale që realizohet në institucionet shkollore kalon nëpër disa faza:

Faza e parë- është momenti kur studenti fillon praktikën profesionale. Ai shkon në shkollë sipas grafikut të caktuar nga NJBEMM me miratimin e FESHSH-së. Studenti kontakton drejtuesin e institucionit dhe mësuesin mentor.

Vëzhgimi i tij do të përqendrohet në:

- Njohjen e mjedisit të shkollës dhe të klasës si mjedis social-pedagogjik.
- Vrojtimin e organizimit të jetës shkollore.
- Studimin e përgjegjësisë të mësuesit,
- Studimin e rregullave të klasës.
- Vrojtimin e punës së përditshme të mësuesit.
- Mënyrën e menaxhimit të klasës.
- Karakteristikat psikologjike të nxënësve të klasës.
- Nevojat e fëmijëve me vështirësi në të nxënë, etj

Faza e dytë- studenti praktikant thellohet në zbatimin e shprehive mësimdhënëse të mësuesit në klasë, diskuton me të të kuptuarit e qartë për procesin e mësimdhënies dhe komponentët e tij.

Faza e tretë- në këtë moment studenti praktikant përparon me tej në kuptimin e procesit të të nxënësve nga fëmijët. Ai fillon gradualisht në bashkëpunim me mësuesin mentor të drejtojë komponentët e veçantë të orës së mësimi. Kërkesat, sugjerimet, ndihmesat, vërejtjet e diskutimet e mësuesit mentor me studentin janë momente mjaft të rëndësishme për përqendrimin e punës së studentit praktikant në lidhjen e tij me klasën.

Gjatë gjithë këtyre fazave pedagogu dhe grupi i stafit akademik nga NJBEMM-ja, vizitojnë rregullisht studentët në shkollë dhe mbajnë shënime për të gjitha vëzhgimet së bashku me mësuesin mentor. Ky bashkëpunim pedagog-student mësues mentor është shumë i rëndësishëm.

Faza e katërt- studenti praktikant kalon në marrjen e klasës në dorë në fillim me orë të veçanta dhe hyn më pas plotësisht në të gjithë realizimin e komponentëve përbërës të mësimdhënies, Lidhja e ngushtë me mësuesin mentor të klasës, diskutimet me pedagogët, rekomandimet metodike të dhëna nga ata mbi elementin e mangësive që shpreh studentit janë momentet më të spikatura të kësaj faze. Në fund të kësaj faze mësuesi mentor i klasës në bashkëpunim me



drejtimin e shkollës bëjnë vlerësimin e nxënësit duke u mbështetur në të gjitha vlerësimet ditore apo javore që janë bërë sistematikisht.

Ky vlerësim për studentin shkon zyrtarisht në NJBEMM dhe tek pedagogu përgjegjës.

Në realizimin sa më me sukses të praktikave profesionale dhe pajisjen e studentëve me kompetenca praktike në procesin e mësimdhënies, janë një sërë aktorësh dhe faktorësh të cilat studenti duhet t'i dije dhe prezantimi me to behet në fillim të vitit akademik. Në vazhdimësi do të prezantojmë rolet, përgjegjësitë dhe të drejtat e gjithë faktorëve që do të bëjnë të mundur realizimin me sukses të praktikave profesionale.

Roli i drejtuesit të shkollës tek studenti praktikant gjatë zhvillimit të praktikës mësimore

- Planifikon programin mësimor që do të zhvillojnë studentët në kohën që ata do të jenë në shkollë
- Kontakton me Departamentin EMM, njihet me objektivat dhe pritshmëritë e këtij elementi të planit mësimor lidhur me praktikën profesionale.
- Qartëson rolin e mësuesit mentor gjatë kohës së punës së studentit në klasë.
- Drejton dhe menaxhon programin e praktikës profesionale të studentëve në shkollë.
- Shpjegon legjislacionin shkollor dhe rregulloren e brendshme të shkollës.
- Familjarizon studentin me dokumentacionin shkollor si dhe nivelin e kompetencave që ka studenti për atë periudhë kohore në klasë.
- Vëzhgon studentin në performancën e tij/saj, bën vlerësime dhe komente gjatë punës së studentit dhe diskuton së bashku me mësuesen ecurinë e studentit
- Bashkëpunon me koordinatoren e universitetit për të rishikuar dhe rivlerësuar cilësinë e përgatitjes së studentit.
- Plotëson në bashkëpunim me mësuesin mentor dokumentacionin përbërës të dosjes së studentit.

Roli dhe përgjegjësitë e mësuesit të klasës (mentor) dhe mësuesit ndihmës.

- Vendos kontaktin me studentin dhe merr informacionin e domosdoshëm.
- Njeh studentin me orarin mësimor, listën emërore të nxënësve, planin mësimor, mënyrën dhe rregullat e klasës etj.
- Njeh studentin me mënyrën si organizon mësimin në klasë dhe teknikat që ai përdor në mësimdhënie për realizimin e objektivave të planit dhe programit të lëndës.
- Koordinon punën me studentin gjatë gjithë kohës së praktikës.
- Ndihmon studentin me mjete dhe burime të ndryshme.
- Vëzhgon marrëdhëniet e studentit me nxënësit dhe komunitetin e prindërve dhe mësuesve.
- Merr pjesë në analizat dhe vlerësimin e studentit, identifikon gjithë nevojat që ka studenti dhe jep rekomandimet sipas rastit.
- Krijon klimë pozitive në klasë.



- Ndikon për rritjen e motivimit të studentit.
- Mban shënime të rregullta vlerësuese për punën e studentit.
- Diskuton me studentin pikat e forta dhe të dobëta të studentit gjatë punës në klasë.
- Është mbështetës gjatë gjithë kohës që studenti është në institucion.
- Diskuton mbi përgatitjen e studentit dhe ecurinë e studentit me koordinаторin e universitetit.
- Vlerësim sipas modelit të shtojcës nr.

Roli i koordinatorit të Universitetit (pedagogu i praktikës profesionale dhe grupi i pedagogëve vëzhgues)

- Njeh rrjetin e shkollave që janë në skemën e praktikave profesionale dhe merr takim si person kontakti me këto shkolla.
- Viziton rregullisht studentët gjatë kohës së zhvillimit të praktikës profesionale.
- Ndjek seminare të ndryshme që lidhen me mësimdhënien në shkollë.
- U siguron informacion studenteve për programin e shkollës dhe gjithçka tjetër u nevojitet.
- Vëzhgon së bashku me mentorin e lëndës procesin e mësimdhënies të studentit në klasë. Ky vëzhgim përfshin veprimtari të ndryshme mësimdhënëse që kryen studenti.
- Shikon dosjen e studentit dhe materiale të tjera të punës së studentit.
- Jep vlerësime dhe komente për punën e studentit duke mbajtur një kopje për vete dhe nga një kopje ia jep mentorit të klasës dhe një studentit.
- Informon departamentin kur ndonjë nga studentët ka probleme madhore në punën e tij në klasë me nxënësit. Në këto raste ai përcakton dhe një program shtesë për të ndihmuar studentin.
- Vlerësim sipas modelit të shtojcës nr.

Detyrat e studentit praktikant:

Studenti praktikant informohet nga pedagogu përgjegjës për punën që do të bëjë gjatë praktikës profesionale në shkollë, legjislacionin, dokumentacionin dhe detyrat e tij/saj. Studenti/ja pajiset me paketën e praktikës profesionale.

Pasi merr informacionet e mësipërme studenti/ja ka për detyrë:

1. Të njihet me shkollën, karakteristikat e saj, përvojën e mësuesit mentor dhe të mësuesit ndihmës me të cilët do të punojë.
2. Të takohet që ditën e parë me drejtuesin e shkollës dhe mësuesin mentor të klasës.



3. Të marrë një program informues të organizimit të shkollës, të mjedisit të klasë, të nxënësve etj.
4. Të njihet me informacionin e marrë nga mësuesi mentor mbi: listën e klasë, orarin e mësimi, planin mësimor, planin javor të mësimi, mënyrën e organizimit të klasës, rregulloren e klasës, nxënësit me nevoja të veçanta.
5. Të diskutojë me mësuesin mentor se çfarë shpreson dhe synon ai të arrijë gjatë praktikës profesionale.
6. Të përgatisë një planë të detajuar për kohën e kryerjes së praktikës profesionale.
7. Të marrë njohuri sistematike për përmbajtjen e lëndës, për orët që do të kryej, veprimtaritë që i nevojiten, materialet didaktike si dhe format e vlerësimit të nxënësit.
8. Të përfshihet në mbledhjet dhe veprimtaritë e aktiviteteve të shkollës dhe të jetë i gatshëm të ofrojë ndihmën e tij.
9. Të sillet në mënyrë profesionale me prindërit, nxënësit, antarë të komunitetit, personel shkollor, etj.
10. Të planifikojë në bashkëpunim me nxënësit aktivitete ekstrakurrikulare.
11. Të zbatojë ligjshmërinë dhe etikën profesionale.
12. Të plotësojë sistematikisht elementët e detyrueshëm të paketës së praktikës profesionale në kohën dhe afatet e duhura.
13. Të hartojë raportin përfundimtar. (shtojca Nr. 2 në Paketën e FESHSH)

Njihet me informacione nga mësuesi mentor mbi;

- listën e nxënësve të klasës;
- orarin e mësimi;
- planin mësimor të lëndës;
- planin javor të mësimi;
- mënyrën e organizimit të klasës;
- rregulloren e klasës;
- nxënësit me nevoja të veçanta;
- vlerësimin sistematike se si bëhet ai vlerësimi në shkollë;
- mënyrën se si të sillet në mënyrë profesionale me çdo njeri që takon, prindërit e nxënësve apo ndonjë pjesëtar të komunitetit;
- planifikimin e javëve dhe orëve mësimore në klasë, detyrave të ndryshme jashtëshkollore që ka klasa;
- përgjegjësitë ligjore që ka në shkollë në lidhje me parandalimin e abuzimeve të ndryshme të nxënësve;
- hartimin e planit mësimor të detajuar për kohën e qëndrimit në praktikën mësimdhënëse në shkollë në orët që ai do të japë mësim;
- përmbajtjen e lëndës, orëve mësimore që do të kryejë, veprimtaritë e ndryshme etj.;
- zbatimin e kodit të etikës së sjelljes dhe të veshjes në institucionet shkollore;



Dosja e studentit

Dosja e studentit mbi praktikën profesionale shkollore është një dokument pune i cili e ndihmon studentin të arrijë standard të larta në procesin e mësimdhënies. Këto arritje vijnë përmes planifikimit të mësimi, shtimit të vëmendjes ndaj këtij procesi dhe vlerësimit me kujdes të çdo elementi që shfaqet gjatë praktikës profesionale. Dosja e studentit është ndërtuar me pesë seksione dhe në përfundim pas prezantimit dorëzohet në NJBEMM.

1. Informacion i përgjithshëm:

- Misioni, vizioni i shkollës.
- Lista emërore e nxënësve.
- Plani vjetor.
- Orari mësimor.
- Mënyra e organizimit dhe rregullore e klasës.
- Nxënësit me nevoja të veçanta në planin shëndetësor, social, ekonomik etj.
- Interesat dhe talentet.

2. Përmbajtja e programit mësimor:

- Informacion mbi nxënësit e klasës në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre.
- Temat e lëndëve që studenti zhvillon, të detajuara sipas planifikimeve të bërë së bashku me mësuesin mentor.
- Shpjegimi i planit të lëndëve që kryen në klasë.
- Veprimtaritë e kryera dhe progresi i tyre.
- Program i punës së diferencuar në klasë, duke detajuar teknikat dhe metodat për të përballuar vështirësitë e ndryshme që shfaqin nxënësit në procesin e të nxënës.
- Informacion mbi arritjet e nxënësve dhe një analizë reflektimi për punën e tij në klasë.
- Plani ditor. Studenti përgatit një informacion me elementët e mëposhtëm:
-orarin, ditarin e mësimi me të gjithë elementët e tij, burimet që do të përdoren, organizimi i klasës, përmbajtja e mësimi, mënyra e vlerësimit të nxënës, puna e diferencuar.
- Në fund të procesit mësimor analizohet puna e ditës së bashku me mësuesin mentor si dhe përcaktohen detyrat për ditën pasardhëse.

3. Plani i angazhimit të studentit praktikant në procesin aktiv të mësimdhënies:

- Studenti së bashku me mësuesin mentor përgatit planin javor, duke detajuar temat që ai/ajo do të zhvillojë.
- Në fund të javës së parë ai e përgatit vetë planin e javës tjetër.



4. Vlerësimi i nxënësve në klasë duhet të pasqyrojë elementet e mëposhtëm:

- Vëzhgimet sistematike.
- Vlerësimin e punëve të nxënësit individualisht dhe në grup.
- Vetëvlerësimin e nxënësit.
- Teste, ese etj.

5. Analiza e veprimtarisë javore të studentit gjatë praktikës profesionale.

Veprimtaria e studentit analizohet në mënyrë periodike në prani të pedagogut përgjegjës/mësuesit mentor gjatë gjithë procesit duke evidentuar shkallën e suksesit në realizimin e detyrave të ngarkuara dhe problematikat e hasura. Në këtë analizë diskutohen arritjet në elementët e mëposhtëm:

- a. programi mësimor,
- b. vlerësimi të nxënësve,
- c. menaxhimi i klasës,
- d. përdorimi i burimeve të ndryshme në procesin e të nxënit,
- e. respektimi i interesave dhe nevojave të nxënësve,
- f. trajtimi i nxënësve me aftësi ndryshe etj.

Të gjithë studentët, një javë para se të fillojnë praktikën profesionale pajisen me shkresën përcjellëse nga Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë drejt institucioneve pritese

I. Vlerësimi i praktikës profesionale për ciklin e parë të studimit Bachelor:

I.1. Vlerësimi i praktikës profesionale pasive zë deri në 40% të vlerësimit total (100%)

I.2. Vlerësimi i praktikës profesionale aktive zë deri në 60% të vlerësimit total (100%)

I ndarë si mëposhtë

I.2.1. Dosja zë deri në 20%

I.2.2. Vlerësimi i mësuesit mentor zë deri në 40%

II. Vlerësimi i praktikës profesionale për programin e ciklit të dytë të studimit “Master Profesional”:

II. 1. Vlerësimi nga institucioni shkollor zë deri në 40% të vlerësimit total (100%)

II. 2. Vlerësimi nga grupi i vëzhguesve (pedagogë) dhe pedagogu i lëndës zë deri në 30% të



vlerësimit total (100%)

II. 3. Vlerësimi i prezantimit të dosjes përpara pedagogut të lëndës zë deri në 30% nga vlerësimi total.(100%)

III. Vlerësimi i praktikës profesionale për programin 2 (dy)- vjeçar me karakter profesional “Edukatorë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme (0-3 vjeç)”.

III. 1. Vlerësimi nga institucioni zë deri në 40% të vlerësimit total (100%)

III. 2. Vlerësimi nga grupi i vëzhguesve (pedagogë) dhe pedagogu i lëndës zë deri në 30% të vlerësimit total (100%)

III. 3. Vlerësimi i prezantimit të dosjes përpara pedagogut të lëndës zë deri në 30% nga vlerësimi total. (100%)

Vlerësimi përfundimtarë i studentit në të gjitha programet e studimit, bëhet me notë , nota kaluese është 5 (pesë)

Sasia e pikëve	0-44 pikë	45-54	55-64	65-74	75-84	88-94	95-100
Nota	4	5	6	7	8	9	10

Përgjegjësi i Njësise Bazë EMM

Doc.dr. Mimoza ÇARKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ”
GJIROKASTËR
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE
NJËSIA BAZË E EDUKIMIT DHE METODOLOGJISË SË MËSIMDHËNIES

MARRËVESHJA E PRAKTIKËS PROFESIONALE

Emri i studentit praktikant: _____

Programi i studimit: Cikli i parë, “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Fillor kl.1-5”

Institucioni pritës: _____

Mbikqyrësi i institucionit: _____

Pedagogu: _____

Periudha e praktikës:

Viti akademik: _____

Semestri: _____

Fillon në datën: _____ **dhe mbaron në datë:** _____



1. Përmbledhje e praktikës profesionale:

Praktika profesionale me studentët e programit të ciklit të parë të studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Fillor kl.1-5”, zhvillohet në institucionet arsimore (shkolla fillore) të Arsimit Parauniversitar, në Republikën e Shqipërisë.

Praktika profesionale zhvillohet sipas modaliteteve të përcaktuar në planin mësimor dhe syllabusit të lëndës. Në semestrit e parë zhvillohen tre javë praktikë pasive dhe në semestrin e dytë zhvillohen tre javë praktikë aktive, nën drejtimin e pedagogëve të caktuar nga NJBEMM.

Praktika profesionale do të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara gjatë formimit teorikë dhe praktikë të studentit nga program i studimit, në një kontekst profesional– shkollë e arsimit fillor nga klasa 1-5-të, dhe do të përsosë aftësitë profesionale që studenti zotëron. Kjo praktikë i ndihmon studentët për të gjetur çështje interesante studimore, të cilat ata mund t'i zhvillojnë gjatë formimit të tyre përfundimtar.

Ky program studimi përcakton në planin mësimor 13 ECTS, të cilat i fiton studenti pasi merr vlerësimin përfundimtar që vërteton përmbushjen me sukses të këtij detyrimi.

Në realizimin e këtyre synimeve një rol të rëndësishëm luan asistenca e personelit akademik përgjegjës për arritjen e objektivave të praktikës profesionale sipas përcaktimeve në programin e studimit. Elementë po aq të rëndësishëm për mbarëvajtjen e këtij komponenti të rëndësishëm janë gjithashtu mësuesit mentor të kualifikuar, mësuesit ndihmës, drejtuesit e shkollave.

Me propozim të Departamentit, Dekanati, në bashkëpunim me Rektoratin, përcakton vendet e zhvillimit të praktikës mësimore/profesionale.

Qendrat ku do të zhvillohen praktikat duhet të jenë të miratuara nga organizmat shtetërore përkatëse dhe duhet të kenë detyrime të kontraktuara me UGJ-në.

Në përfundim të praktikës studenti bën mbrojtjen e saj para pedagogëve që e udhëheqin atë, duke paraqitur dokumentet e përcaktuara në marrëveshje.

2. Objektivat e praktikës profesionale.

Gjatë praktikës profesionale studenti duhet të jetë në gjendje:



1. Të përdorë shprehitë bazë të mësimdhënies, të komunikimit dhe të bashkëpunimit në klasë dhe jashtë saj, duke respektuar të gjithë nxënësit.
2. Të kuptojë qëllimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit, duke ndihmuar dhe zhvilluar tek nxënësi aftësitë për të zbatuar, krahasuar, arsyetuar dhe vlerësuar.
3. Të demonstrojë njohje të saktë të njohurive bazë të lëndëve mësimore që ai do të trajtojë, duke reflektuar përgjegjësi akademike.
4. Të gjykojë se në çfarë mase nxënësit shfaqin vështirësi në të nxënë, duke identifikuar nevojat dhe interesat e tyre.
5. Të planifikojë veprimtari mësimdhënëse dhe aktivitete zhvillimore në përshtatje me analizat e kryera për arritjet e standardeve të kërkuara.
6. Të aftësohet për një komunikim profesional me mësuesit e shkollës dhe prindërit e nxënësve.
7. Të përdorë strategji dhe teknika mësimdhënëse, duke nxitur interesin, kreativitetin motivimin dhe besimin e nxënësit.
8. Të menaxhojë me efektivitet kohën e tij dhe të nxënësit, duke gjetur forma dhe metoda të ndryshme në mësimdhënie/nxënie dhe vlerësimin e çdo nxënësi.
9. Të demonstrojë aftësi gjithëpërfshirëse ndaj nevojave të nxënësve me aftësi ndryshe, duke bashkëpunuar dhe me mësuesin ndihmës.

3. Detyrat e studentit praktikant:

Studenti praktikant informohet nga pedagogu përgjegjës për punën që do të bëjë gjatë praktikës profesionale në shkollë, legjislacionin, dokumentacionin dhe detyrat e tij/saj. Studenti/ja pajiset me paketën e praktikës profesionale.

Pasi merr informacionet e mësipërme studenti/ja ka për detyrë:

1. Të njihet me shkollën, karakteristikat e saj, përvojën e mësuesit mentor dhe të mësuesit ndihmës me të cilët do të punojë.
2. Të takohet që ditën e parë me drejtuesin e shkollës dhe mësuesin mentor të klasës.
3. Të marrë një program informues të organizimit të shkollës, të mjedisit të klasës, të nxënësve etj.
4. Të njihet me informacionin e marrë nga mësuesi mentor mbi: listën e klasës, planin e mësimimit, planin mësimor, planin javor të mësimimit, mënyrën e organizimit të klasës rregulloren e klasës, nxënësit me nevoja të veçanta.
5. Të diskutojë me mësuesin mentor se çfarë shpreson dhe synon ai të arrijë gjatë praktikës profesionale.
6. Të përgatisë një planë të detajuar për kohën e kryerjes së praktikës profesionale.



7. Të marrë njohuri sistematike për përmbajtjen e lëndës, për orët që do të kryej, veprimtaritë që i nevojiten, materialet didaktike si dhe format e vlerësimit të nxënësit.
8. Të përfshihet në mbledhjet dhe veprimtaritë e aktivitetet e shkollore dhe të jetë i gatshëm të ofrojë ndihmën e tij.
9. Të sillet në mënyrë profesionale me prindërit, nxënësit, antarë të komunitetit, personel shkollor, etj.
10. Të planifikojë në bashkëpunim me nxënësit aktivitete ekstrakurrikulare.
11. Të zbatojë ligjshmërinë dhe etikën profesionale.
12. Të njihet me dokumentacionin e detyrueshëm të paketës së praktikës profesionale si dhe me mënyrën, afatet e plotësimit të këtij dokumentacioni.
13. Të hartojë raportin përfundimtar.

4. Produktet e praktikës (Dosja):

Dosja e studentit mbi praktikën profesionale shkollore është një dokument pune i cili e ndihmon studentin të arrijë standard të larta në procesin e mësimdhënies. Këto arritje vijnë përmes planifikimit të mësimi, shtimit të vëmendjes ndaj këtij procesi dhe vlerësimit me kujdes të çdo elementi që shfaqet gjatë praktikës profesionale. Dosja e studentit është ndërtuar me pesë seksione dhe në përfundim pas prezantimit dorëzohet në NJBEMM.

4.1. Informacion i përgjithshëm:

- Misioni, vizioni i shkollës.
- Lista emërore e nxënësve.
- Plani vjetor.
- Orari mësimor.
- Mënyra e organizimit dhe rregullore e klasës.
- Nxënësit me nevoja të veçanta në planin shëndetësor, social, ekonomik etj.
- Interesat dhe talentet.

4.2. Përmbajtja e programit mësimor:

- Informacion mbi nxënësit e klasës në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre.
- Temat e lëndëve që studenti zhvillon, të detajuara sipas planifikimit të bërë së bashku me mësuesin mentor.
- Shpjegimi i planit të lëndëve që kryen në klasë.
- Veprimtaritë e kryera dhe progresi i tyre.
- Program i punës së diferencuar në klasë, duke detajuar teknikat dhe metodat për të përballuar vështirësitë e ndryshme që shfaqin nxënësit në procesin e të nxënit.
- Informacion mbi arritjet e nxënësve dhe një analizë reflektimi për punën e tij në klasë.



- Plani ditor. Studenti përgatit një informacion me elementët e mëposhtëm:
-orarin, ditarin e mësimi me të gjithë elementët e tij, burimet që do të përdoren, organizimi i klasës, përmbajtja e mësimi, mënyra e vlerësimit të nxënësit, puna e diferencuar.
- Në fund të procesit mësimor analizohet puna e ditës së bashku me mësuesin mentor si dhe përcaktohen detyrat për ditën pasardhëse.

4.3. Plani i angazhimit të studentit praktikant në procesin aktiv të mësimdhënies:

- Studenti së bashku me mësuesin mentor përgatit planin javor, duke detajuar temat që ai/ajo do të zhvillojë.
- Në fund të javës së parë ai e përgatit vetë planin e javës tjetër.

4.4. Vlerësimi i nxënësve në klasë duhet të pasqyrojë elementet e mëposhtëm:

- Vëzhgimet sistematike.
- Vlerësimin e punëve të nxënësit individualisht dhe në grup.
- Vetëvlerësimin e nxënësit.
- Teste, ese etj.

4.5. Analiza e veprimtarisë javore të studentit gjatë praktikës profesionale:

- Veprimtaria e studentit analizohet në mënyrë të periodike në prani të pedagogut përgjegjës/mësuesit mentor gjatë gjithë procesit duke evidentuar shkallën e suksesit në realizimin e detyrave të ngarkuara dhe problematikat e hasura. Në këtë analizë diskutohen arritjet në elementët e mëposhtëm:
 - a. programi mësimor,
 - b. vlerësimi të nxënësve,
 - c. menaxhimi i klasës,
 - d. përdorimi i burimeve të ndryshme në procesin e të nxënit,
 - e. respektimi i interesave dhe nevojave të nxënësve,
 - f. trajtimi i nxënësve me aftësi ndryshe etj.

5. Mënyra e vlerësimit të praktikës:

Në përfundim të praktikës studentit bën mbrojtjen e saj para pedagogëve që e udhëheqin atë. Vlerësimi mbështetet mbi komponentët e mëposhtëm:



- a. Vlerësim i praktikës profesionale të firmosur nga mësuesi mentor dhe drejtuesi i shkollës .
(Dokumenti vuloset me vulën e institucionit pritës) (40 pikë)
- b. Dokumente evidentuese të zhvillimit të praktikës profesionale (Dosja dhe elementët e saj).
(20 pikë)
- c. Vlerësimi i praktikës pasive e zhvilluar në semestrin e parë nën udhëheqjen e pedagogut të lëndës. (40 pikë)

Pesha specifike e elementëve të mësipërm përcaktohet duke u mbështetur në modalitetet e planit mësimor, sipas programit të studimit tek syllabusi i praktikës profesionale.

Studenti praktikant rezulton kalues kur ai vlerësohet minimalisht me 45 pikë.

Konvertimi i pikëve në notë bëhet sipas skemës në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Sasia e pikëve	Nota
1.	1-44 pikë	nota 4
2.	45-54 pikë	nota 5
3.	55-64 pikë	nota 6
4.	65-74 pikë	nota 7
5.	75-84 pikë	nota 8
6.	85-94 pikë	nota 9
7.	95-100 pikë	nota 10

STUDENTI

PEDAGOGU

MËSUESI MENTOR

(nënshkrimi)

(nënshkrimi)

(nënshkrimi)



Shtojca nr.1**FORMULAR I VLERËSIMIT TË ZHVILLIMIT TË MËSIMIT****Emri i studentit/es:** _____**Programi i studimit** _____**Shkolla:** _____**Data:** _____**Klasa:** _____

I. Njohuri mbi lëndën	Vlerësimi	
• Demonstrimi i njohurive, koncepteve dhe shprehive sipas programit mësimor.		
• Demonstrimi në thellësi i njohurive të lëndës.		

II. Metodologjia	Vlerësimi	
• Ndërtimi i planifikimit të planit mësimor.		
• Sigurimi i vazhdueshëm dhe progresionit të lëndës.		
• Mënyra e shpjegimit të mësimin.		
• Komentimin e lëndës me një gjuhë të qartë dhe në mënyrë tërheqëse.		
• Ndihmesën për zhvillimin e gjuhës së nxënësit dhe aftësitë komunikuese.		
• Demonstrimin e aftësive për të zgjedhur e përdorur burime të përshtatshme.		

III. Menaxhimi i klasës	Vlerësimi	
• Veprimtari të përshtatshme gjatë mësimdhënies për të tërë klasën, grupet, çiftet e nxënësve për të arritur qëllimet e veçanta të të nxënësit.		
• Krijimin e një mjedisi të rregullt për nxënësit.		
• Përdorimin e përshtatshme të vlerësimit të rregullave për një mjedis produktiv të nxënësit.		
• Përmbytja e qëllimit të nxënësit dhe motivimin e tij.		

IV. Vlerësimi i përparimit të nxënësit	Vlerësimi	
• Aftësia në identifikimin e nivelit të nxënësit.		
• Aftësia e gjyqimit të shkallës së arritjes së standardeve sipas moshës së nxënësit.		



• Vlerësimin dhe regjistrimin sistematik të programit individual të nxënësit.		
• Përdorimi i vlerësimeve gjatë procesit të mësimdhënies.		
• Demonstrimin e të kuptuarit të përparimit të nxënësit dhe raportimin e tij.		
• Ndërtimi i planifikimit të planit mësimor.		

V. Zhvillimi profesional	Vlerësimi
• Të kuptuarit e studentit të rolit të shkollës dhe vendi i saj në komunitet.	
• Përgjegjësitë ligjore dhe administrative si mësues.	
• Aftësitë e studentit për komunikim efikas të punës me kolegët, prindërit dhe nxënësit.	
• Vetëdijen e tij për ndryshimet individuale që përfshijnë dimensionet sociale, psikologjike e kulturore.	
• Aftësia e tij për të njohur llojshmërinë e talenteve që përfshihen tek nxënësit e veçante.	
• Aftësinë për të përcaktuar ose identifikuar vështirësitë e të nxënit.	
• Vlerësimin kritik për diagnostifikimin dhe vlerësimin e të nxënit duke përfshirë një njohje të efekteve që jep ai në krahasim me atë që prët mësuesi.	
• Gatishmëria për të nxitur nivelin moral e shpirtëror të nxënësit.	

Në krahasim me çdo shprehje do të vendoset një nga shprehjet: *dobët, mjaftueshëm, mirë, shumë mirë.*

(Ky është një format vlerësimi që e përdor mësuesi mentor ose pedagogu gjatë ditëve që studenti zhvillon praktikën profesionale. Analiza e këtyre vlerësimeve së bashku me komponentë të tjerë vlerësues shërben për vlerësimin përfundimtar të studentit praktikant.)

STUDENTI

MËSUESI/PEDAGOGU

(nënshkrimi)

(nënshkrimi)



PROGRAMI I LËNDËS PRAKTIKË PROFESIONALE

Titullari /pedagogu i lëndës: Aida Sotiri Msc, Valbona Caushi Msc

Ngarkesa: 30 (ECTS), 15 javë

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: 2020-2021, semestri II, Viti II

Lloji i lëndës: E detyrueshme

Programi i studimit: Program dy vjeçar me karakter profesional "Edukatorë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme (0-3 vjeç)"

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:

Kodi i etikes: Pedagogu dhe studenti duhet të respektojë rigorozisht tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-së dhe të programit të studimit

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Praktika profesionale, bazohet në lidhjen e ngushtë midis universitetit, pushtetit vendor dhe shkollave të sistemit parauniversitar si partnerë bazë. Kjo periudhë e studimeve është një moment i rëndësishëm në përfitimin e përvojave të para arsimore të studentët. Praktika profesionale është pjesë e programit mësimor dhe zhvillohet në fund të semestrit të dytë të vitit të dytë të studimeve. Qëllimi i praktikës është aftësimi profesional i studentëve nëpërmjet praktikës në institucionin e çerdhës. Rol të rëndësishëm në këtë periudhë, luan ndihma e edukatoreve mentore të kualifikuara, të cilat i ndihmojnë studentët me karakteristikat e çdo fëmije, evidentimin e nevojave që kanë ata, menyrën si organizojnë ditën "mësimore" Studentët do të njohin aspektet dhe problematikat e punës me fëmijët, familjet dhe profesionistët. Një praktikë e mirë i pajis studentët me njohuri për karrierë dhe krijon përvojë reale për kërkesat e përditshme të profesionit që kanë zgjedhur. Kjo do të thotë se studentët do të jenë më të përgatitur për tu hedhur në tregun e punës. Studentët do të zhvillojnë një sërë aftësish komunikuese dhe praktike. Ato kanë lidhje të drejtpërdrejtë me formimin e tyre, me zhvillimin profesional dhe me ushtrimin e profesionit. Në përfundim të programit, studenti përfiton:

Pas përfundimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje:

Të aftësohen të përdorin strategji dhe teknika mësimdhënie me fëmijët e moshës 0-3 vjeç

- Të përfitojnë kompetenca për t'u punësuar në institucionet shtetërore ose private për fëmijët 0-3 vjeç, duke qenë të specializuar në edukimin e grupmoshave 0-3 vjeç.
- Të aftësohen të pajisin fëmijët e kësaj moshe me njohuritë, aftësitë e domosdoshme për të përballuar kërkesat e të gjitha fushave të formimit.
- Të përfshijnë natyrshëm në procesin e të nxënit të gjithë fëmijët e kësaj moshe, duke marrë parasysh problemet dhe aftësitë e tyre.
- Të zhvillojnë aftësi e shprehi për tu ekspozuar me punën në botën reale



- Të motivohen që të zhvillojnë individualisht profesionin e tyre
- Të aftësohen të punojnë në grup me njerëz të rinj dhe profesionistë
- Të lënë impakt pozitiv tek mjediset ku do të kryejnë praktikën preofesionale.

KONCEPTET THEMELORE:

1. Çerdhe ;
2. Fëmijë ;
3. Grup mosha ;
4. Aftësi ndryshe;
5. Metodologji;
6. Planifikim;
7. Praktikë;

TEMAT E LËNDËS:

Tema I : Vëzhgimi në kontekstet edukative të fëmijëve: të njohësh tjetrin, të krijosh marrëdhënie dhe të nxitësh zhvillimin

Në javën e parë studentët do të vëzhgojnë dhe mbajnë shënime për mënyrën si funksionon jeta e fëmijëve në çerdhe. Funksionin e cdo edukatoreje dhe marrëdhëniet me kujdestarët e fëmijëve.

1. Njohja me mjedisin e çerdes.
2. Prezantimi me stafin mbështetës dhe atë ndihmës
3. Prezantimi i planit të punës dhe aktiviteteve ditore
4. Prezantimi me rregulloren dhe oraret në të cilën do të punojnë
5. Prezantimi me kujdestarët e fëmijëve
6. Dokumentacioni dhe udhëzimet që do ti shoqërojnë studentët
7. Prezantimi me edukatore të mentore



Tema II: Mjedisi i çerdhes dhe puna në grup

Puna në grup apo puna si një skuadër është veçanërisht e nevojshme në arsimin parashkollor, për vetë natyrën e funksionimit të këtij niveli arsimit apo për shkak të grupmoshës së fëmijëve. Njohja dhe mbajtja parasysh e roleve të mundshme që anëtarët e grupit duhet të marrin ka rëndësi për të siguruar normalitetin në punën me grupe në kopsht.

1. Caktimi i detyrave të secila edukatore (pritëse, me ushqimin, aktivitetet jashtë, aktivitetet Brenda, gjumi)
2. Organizimi i mjedisit para dhe pas ngrënies dhe gjumit
3. Organizimi i takimeve me kujdestarët e fëmijëve

Tema III : Qëndrat e aktivitetit

Qendrat e aktivitetit

Mjedisi fizik ndikon në mënyrën si ndihen fëmijët. Rregullimi i klasës dhe përzgjedhja e materialeve u përshtatet mesazheve dhe mbështet qëllimet e të nxënësve. Edukatorët, vlerësojnë efektivitetin e mjedisit të të nxënësve dhe e përshtatën atë kërkesave të reja për ndryshim. Rëndësi ka përzgjedhja e sendeve në përshtatje me moshën e fëmijëve 0 – 3 vjeç

1. Qendra e blloqeve
2. Qendra e gatimit
3. Qendra e manipulimit
4. Qendra e lodrave muzikore
5. Qendra e artit

Tema IV : Planifikimi i veprimtarive javore dhe ditore

Planifikimi i veprimtarive javore dhe ditore

1. Cfarë duhet marrë parasysh kur bëhet planifikimi?
2. Organizimi dhe gjendja e materialeve që përzgjidhen për temat
3. Përmbylljen e nevojave të fëmijëve
4. Përshtatja me moshën e fëmijëve
5. Përshtatja e mjedisit të kopshtit dhe ato që ofron mjedisi

Tema V: Njohja me familjet dhe kujdestarët

Në shumicën e rasteve, për fëmijët kujdesen prindërit e tyre, kujdestarët ligjorë ose motrat dhe/apo të afërmit. Në disa raste, gjithashtu shihet se për fëmijët kujdesen fëmijët e tjerë. Kjo përkujdesje informale përfshin drejtimin verbal, ushtrime dhe trajnime të tjera të qarta në lidhje me sjelljen e fëmijës.

1. Njohja dhe prezantimi i studenteve me familjet dhe kujdestarët
2. Trajnime me prindërit
3. Takim prindër psikologe
4. Aktivitete me prindër në ndihmë të edukatoreve
5. Përgatitja e fletëve të informacionit, dhe fletëpalosjeve me aktivitete të përbashkëta prindër fëmijë



Tema VI: Harta sociale e familjeve dhe fëmijët me probleme

Harta sociale e familjeve dhe fëmijët me aftësi ndryshe

çdo fëmijë pavarësisht nga diferencat individuale ka nevojë të ndihet i pranuar, i vlerësuar dhe të ketë shokë. Studentët pajisen me një numër strategjish që ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve të sjelljes dhe menaxhimin e fëmijëve të të gjitha individualiteteve në klasë.

1. Njohja e familjeve me problematiken ekonomike dhe sociale
2. Njohja me fëmijët me aftësi ndryshe
3. Planifikimi dhe objektivat e punës me fëmijët me aftësi ndryshe
4. Aktivitete argëtuese gjithpërfshirëse me prindër dhe fëmijë

Tema VII: Përgatitja e mjeteve mësimore

1. Mjeti përkatës a është i përshtatshëm për moshën e fëmijëve ?
2. A është i përshtatshëm në krahasim me nivelin e aftësive përdoruese të fëmijës?
3. Mjeti i caktuar a meriton që t'i kushtohet aq kohë dhe përpjekje sa ai kërkon ?
4. A nxisin interesin e fëmijëve për përdorim?
5. Përgatisin së bashku me fëmijët e figurave me aplikacion

Tema VIII: Gjuha dhe komunikimi. (Aktivitete praktike)

Aftësia për të komunikuar në mënyrë efektive është thelbësore në të gjitha aspektin e zhvillimit të fëmijës. Zhvillimi i gjuhës së folur është pika e nisjes në procesin e komunikimit të fëmijëve të moshës 0-3 vjeç. Fëmijët fillojnë dalëngadalë të shprehin me fjalë dhe fjali të thjeshta nevojat, mendimet dhe ndjenjat e tyre.

1. Aftësojnë fëmijët të identifikojnë simbolet e tyre
2. Aftësojnë fëmijët të identifikojnë shkronja të thjeshta të shoqëruara me figura
3. Organizojnë lojëra lëvizore muzikore
4. Lexojnë përralla nëpërmjet fletëpalosjeve me figura

Tema IX : Shëndeti, mirëqënia fizike dhe zhvillimi motorik i fëmijës 0-3 vjeç

Që kur lindin fëmijët duan të eksplorojnë botën ku erdhën të jetojnë. Këtë e bëjnë duke lëvizur sytë, gojën, duart drejt njerëzve dhe objekteve që kanë përreth. Duke u rritur vendosmëria e fëmijëve për të zotëruar lëvizje, ekuilibra dhe shprehje fine motorike vazhdon të mbetet e fortë.

1. Aftësohen studentët të organizojnë lojëra në natyrë
2. Aftësohen studentët të ndihmojnë fëmijët të përdorin biçikletat
3. Aftësohen studentët të organizojnë lojëra interesante me ujë
4. Aftësohen studentët të monitorojnë fëmijët ndërsa ata janë duke lozur në një park lodrash



Tema X : Zhvillimi i koncepteve sasi numër

Dikur mendohej se deri në momentin kur arrihej të fliste, fëmija nuk ishte në gjendje të mendonte dhe të formonte ide komplekse, por studiuesit kanë vërtetuar se që në javët e para të jetës foshnjat nxënë në mënyrë aktive. Ata mbledhin dhe organizojnë njohuri rreth botës së tyre.

1. Studentët aftësohen të punojnë me materiale me kuba
2. Organizojnë aktivitete për madhësinë, ngjyrat, format
3. Organizojnë aktivitete me numrat dhe numërimin
4. Organizojnë aktivitete për sasinë dhe korespondencën

Tema XI : Teknika të menaxhimit të zemërimit.

Sot fëmijët përballen me shumë lloje presionesh apo stresesh të përditshme. Vetëm të mendosh mbi llojet e imazheve të frikshme ndaj të cilave fëmijët ekspozohen, në lajmet e darkës: trazirat, krimet brenda familjes, të shtëna, bombardime, rrëmbime, vrasje të pakuptimta. Gjithashtu situatë tjetër stresuese me të cilën ata përballen janë ngacmimet e ndryshme në shkollë (bulling). A ndikojnë të gjitha këto tek fëmijët? Patjetër që po.

Si të flasim me fëmijët në çdo moshë ndërsa ai rritet

1. Si të ndërtojmë lidhje emocionale dhe të ndihmojmë fëmijët të zbulojnë botën
2. Rëndësia e inkurajimit të kureshtjes dhe të mësimin të gjërave rreth vetvetes për fëmijët
3. Teknika të punës me prindër për menaxhimin e zemërimit
4. Mënyra se si të parandalojmë dhe shmangim zemërimin

Tema XII: Lojëra lëvizore me karakter matematikor, gjuhësor

1. Përzgjedhja e lojërave me karakter muzikor, matematikor, gjuhësor
2. Aftësohen studentët të përshtatin lojërat me moshën zhvillimore të fëmijëve
3. Aftësohen studentët të përdorin teknologjinë në lojërat e fëmijëve

Tema XIII : Vlerësimi i studentëve

1. Dorëzimi i dokumentacionit, plan javor, plan ditor, punime të fëmijëve
2. Vlerësimi i punës së edukatores mentore

Tema XIV: Muzika dhe ritmi në lojërat e fëmijëve

Kur në klasë zhvillohen veprimtari muzikore dhe lëvizore për fëmijët nuk krijohen vetëm mundësi për ti vënë në lëvizje, apo për ti bërë ata të lëvizin sipas një ritmi të caktuar, por njëkohësisht i zhvillojnë në fushat emocionale, fizike, intelektuale dhe gjuhësore.

1. Aftësohen studentët të ndihmojnë fëmijët të performojnë sipas dëshirës melodi, kërcime.
2. Aftësohen studentët të ndihmojnë fëmijët të lëvizin trupin duke bashkëvepruar me melodinë, ritmin, karakterin.
3. Aftësohen studentët të ndihmojnë fëmijët të përjetojnë këngët dhe lojërat muzikore për fëmijë.



Tema XV: Tregimet e ilustruara

1. Aftësohen studentët të ndihmojnë fëmijët shprehin përjetimet që i kanë shoqëruar gjatë shikimit dhe dëgjimit të një filmi, dokumentari, ekspozite, dramatizimi, recitimi, interpretimi muzikor ose leximit të një libri në njërën nga format shprehëse (me gojë, me shkrim, vizatim, mimikë, lëvizje etj.);
2. Aftësohen studentët të merren me organizimin e një shfaqjeje artistike të veshur me kostume artistike;
3. Aftësohen studentët të ndihmojnë fëmijët të identifikojnë personazhet kafshë të një teksti me figura
4. Aftësohen studentët të ndihmojnë fëmijët të shprehin me gojë fjali të thjeshta rreth figurave

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

- Vlerësimi nga institucioni shkollor deri në 40% të vlerësimit total (100%)
- Vlerësimi nga grupi i vëzhguesve (pedagogë) dhe pedagogu i lëndës deri në 30% të vlerësimit total
- Vlerësimi i prezantimit të dosjes përpara pedagogut të lëndës deri në 30% nga vlerësimi total.

PROVA FINALE: Pas prezantimit të dosjes studenti vlerësohet me një notë përfundimtare.

- Pikët që studenti merr nga vlerësimet e mësipërme ekuivalentohen me notë.
- Studenti rezulton kalues me minimalisht 45% të vlerësimit total apo 45 pikë.



LITERATURA

a) Literatura bazë e detyrueshme:

- Cekani, E. H. (2010). *Libri i mësueses së arsimit parashkollor*. Tiranë: Polis.
- Cekani, E. H. (2012). *Metodika sipas fushave të zhvillimit*. Tiranë: Polis.
- Coughlin et al. (1997). *Hap pas Hapi: Një program për fëmijët dhe familjet: Krijimi i klasave me fëmijët në epiqendër: fëmijët 3-5 vjeçarë*. Uashington, D.C: Organizata Ndërkombëtare e Burimeve për Fëmijë.
- *Mësoj si nxënës, luaj si fëmijë* "përgatitur nga autoret: Saranda Kumnova Pozhegu dhe Aurela Zisi

b) Literatura e rekomanduar:

- Hido, M. "Familja dhe komuniteti ne edukim", 2016
- Durrant, J. "Disiplina pozitiv në prindërimin e përditshëm" 2013, fq.45-65;129-151
- Garaldini, Carocci. "Cresere al nido, gli spazi, le attività, le relazioni" Roma 2003
- Dolto, R. *Etapat kryesore të fëmijërisë*, Tirane.

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS:

Studentët janë të detyruar të veprojnë në përputhje me dhe të respektojnë në mënyrë rigoroze tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-së për t'u sjellë me integritet akademik mbështetur në ndershmërinë.

Studentet janë të detyruar:

- Të prezantojnë punën e tyre individuale
- Të mos kopjojnë dhe paraqesin punën e dikujt tjetër
- Të mos fabrikojnë apo manipulojnë të dhënat
- Të respektojnë integritetin dhe dinjtetin njerëzor & profesional të personelit akademik dhe atij ndihmës
- Të respektojnë integritetin dhe dinjtetin njerëzor & profesional të studentëve të tjerë

Në rast shkeljesh të këtyre rregullave, studentët penalizohen, siç parashikon rregullorja e UGJ- së dhe rregullorja e Programit të Studimit.





UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE
DEPARTAMENTI I LETËRSISË

PROGRAMI I PRAKTIKËS AKTIVE

PËR STUDENTËT E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE
MASTER NË "MËSUESI NË AMU NË GJUHË -LETËRSI"



MIRATOHET
DEKANI
(Prof. dr. Gëzim Sala)

PERIUDHA E ZHVILLIMIT TË PRAKTIKËS

HYRJE

Në zbatim të kërkesave të planit mësimor dhe të programeve mësimore, pas mbarimit të orëve teorike e praktikave të metodikës së gjuhës dhe të letërsisë; studentët e programit mësimor *Master në "Mësuesi në AMU në gjuhë- letërsi "* do të kryejnë *praktikën aktive shkollore* të mësimdhënies në shkollat 9- vjeçare.

QËLLIMI I PROGRAMIT TË PRAKTIKËS

Si formë e rëndësishme e organizimit të procesit mësimor në shkollën e lartë që përgatit mësues, praktika aktive shkollore e mësimdhënies ka për qëllim të aftësojë studentët nga pikëpamja profesionale, për të dhënë mësim në përputhje me kërkesat bashkëkohore që shtrohen sot për forcimin cilësor të shkollës dhe për t'i aftësuar me shprehje praktike për shkollën dhe jetën.



KANDIDATËT DO TË KENË KËTO DETYRA

1. Kandidati të zhvillojë orë mësimi me nivel të mirë, duke u përgatitur seriozisht e me përgjegjësi për orën e mësimi nga ana shkencore dhe pedagogjike-metodike.

2. Të realizojë, në lidhje organike, të gjitha momentet e orës së mësimi, në bazë të hartimit të plankonspektit të detajuar, duke i kushtuar kujdes realizimit të të gjitha objektivave pedagogjike.

3. Kandidati të përdorë pyetje logjike, argumentime, interpretime, analiza, krahasime, përfundime dhe të nxjerrë konkluzione për dukuritë, ngjarjet e faktet që analizon. Në tërë procesin e punës të udhëhiqet nga përvoja bashkëkohore perëndimore që shprehet në literaturën metodike që qarkullon sot.

4. Të krijojë situata problemore në orët e mësimi, duke lidhur natyrshëm punën e mësuesit me atë të nxënësit në orën e mësimi, me një veprimtari të gjallë e efektive.

5. Të aftësojë nxënësit për zgjidhjen e detyrave të pavarura në klasë e në shtëpi në mënyrë krijuese, kundër riprodhimit mekanik.

6. Kandidati çdo ditë të jetë i përgatitur me një plankonspekt të hollësishëm e **të miratuar një ditë më parë nga mësuesi mentor** i shkollës ku kryen praktikën.

7. Kandidati të ndjekë të gjitha aktivitetet me karakter kulturor e edukativ brenda e jashtë shkollës.

8. Të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet dhe aktivitetet me karakter shkencor-pedagogjik që do të zhvillohen gjatë praktikës e të japë mendime të lira e të pavarura.

9. Kandidati do të ketë **fletoren e veçantë të shënimeve**, të analizave të orëve, vërejtjet e detyrat e lëna nga mësuesi formator, metodist, pedagogu apo drejtori, pas çdo ore të vëzhguar.

10. Kandidati gjatë praktikës **nuk lejohet të largohet nga shkolla**. Për mungesat në raste të veçanta, ditët e humbura të praktikës do t'i kryejë në një periudhë kohe që cakton departamenti.

11. Në fund kandidati do të përgatitë vetë një relacion të hollësishëm të aktivitetit të tij në praktikë.

ROLI I MËSUESIT MENTOR GJATË PRAKTIKËS PEDAGOGJIKE NË SHKOLLË

a) Në periudhën tri ditore të vëzhgimit

1. Mësuesi mentor të japë orë mësimi shembullor me nivel të lartë shkencor e metodik, në përputhje me kërkesat e reja.

2. Të njohë kandidatin me problemet e klasës, t'i japë sqarime për sjelljen e nxënësve, përparimin në mësim, sqarime e këshilla për ndonjë nxënës të veçantë, për detyrat me shkrim e punën e diferencuar me nxënësit e veçantë etj.

3. Të njohë kandidatin me dokumentacionin shkollor, si me atë shtetëror dhe ato që i takojnë mësuesit siç janë: Plani vjetor, amza, regjistri, programi mësimor i lëndës, plani kalendar, plani ditar, metodat që ka përdorur, mënyrat, literaturën që ka përdorur e pikësynimet e programit për secilën klasë etj.

4. Të njohë kandidatin me punën brenda dhe jashtë klase, me takimet me prindër e mësues dhe me punën që do të bëjë me prindërit në të ardhmen.



5. Të njohë kandidatët me planin vjetor të tij dhe me detyrat e mësuesit dezhurn në shkollë.

6. Mësuesi mentor në fund të orëve të mësimit të zhvillojë me kandidatin analiza të hollësishme të orëve të mësimit dhe t'i udhëzojë ata për mësimin e ditës tjetër. Të kërkojë që kandidati të mbajë shënim si për arritjet pozitive dhe për ato negative.

b) Gjatë dhënies së mësimit nga kandidati mësuesi mentor do të ketë këto detyra:

1. Të kontrollojë me përgjegjësi e plotësisht përgatitjen e kandidatit që nga plankonspekti, i cili të jetë i firmosur një ditë para e deri te mjetet mësimore.

2. Të asistojë në çdo orë mësimi dhe në aktivitetet e kandidatëve me nxënësit e të mbajë shënime të plota që lidhen me zhvillimin e orëve të mësimit.

3. Të japë vlerësime ditore objektive për kandidatin, për aftësimin e tij dhe evolucionin që arrin ai nga ora në orë.

4. Të njohë kandidatin me punën jashtë klase e shkolle dhe të planifikojë veprimtari të tilla, ku rolin kryesor ta luajë kandidati.

5. Të njohë kandidatin me rregulloren e shkollës të ardhur nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, apo rregulloren e brendshme si dhe me legjislacionin përkatës që lidhet me problemet e shkollës e të të mësuesit.

PËRMBAJTJA E PRAKTIKËS

- Praktika aktive shkollore e mësimdhënies e studentëve të vitit të dytë Master në "Mësuesi në AMU në gjuhë -letërsi" zhvillohet për 8 javë në shkollat 9 - vjeçare.

- Kandidati tri ditët e para do të vëzhgojë orë mësimi të mësuesi mentor me strukturë e tipe të ndryshme.

- Kandidati të njihet me planet kalendarike e ditarin e mësuesit metodist dhe lëndët që do të zhvillojnë gjatë praktikës.

- Kandidati do të zhvillojë nga 10 -12 orë mësimi gjuhe dhe letërsi në javë në prani të mësuesit mentor apo të ndonjë vëzhguesi tjetër (drejtori, student apo pedagog) dhe mbi këtë ngarkesë të mos marrë asnjë orë tjetër.

- Kandidati pas përfundimit të praktikës të marrë relacionin për punën e tij, të hartuar nga mësuesi mentor dhe të firmosur nga drejtori, me vlerësimin përkatës dhe ta dorëzojë te pedagogu metodist.

- Në mbarim të praktikës, të gjithë mësuesit mentorë kanë të drejtë të japin mendime, vërejtje, propozime për punën e bërë nga departamenti, dekanati dhe Universiteti, në drejtim të përgatitjes së studentëve dhe përmirësimit të mëtejshëm të saj.

Këto mendime mund t'i dërgojnë pranë departamentit apo t'i shfaqin në konsultat që organizohem.

- Gjatë praktikës pedagogu metodist në bazë të detyrave të departamentit bashkë me pedagogët e tjerë, ndjek nga afër përgatitjen e studentëve dhe vëzhgon orë mësimi të tyre në praktikë.



- Pedagogët që ndihmojnë studentët dhe bëjnë shënime në fletoren e kandidatit (plankonspektit), të marrin pjesë në analizat e orës duke dhënë mendime dhe orët e vëzhguara t'i pasqyrojnë në fletoren e tyre, për llogari të ngarkesës mësimore.
- Konkluzionet e mendimet e tyre t'i shërbejnë përmirësimit të praktikës.
- Në mbarim të praktikës studenti duhet ta mbrojë një orë mësimi para Komisionit të praktikës profesionale.

Përgjegjësi i depart. të Gjuhës
(Prof. asoc. Spiridhulla Poçi)



Përgjegjësi i depart. të Letërsisë
(Prof. asoc. Merita Gjokutaj-Shehu)




Gjirokastër, më 13 . 11. 2020



PROGRAMI I LËNDËS

PRAKTIKË SHKOLLORE E MËSIMDHËNIES PASIVE DHE AKTIVE

Titullari /pedagogu i lëndës: Entela Kore, Dr. Ermelinda Kashah, Dr. 
Ngarkesa: 12 ECTS, 60 orë në auditor, 4 orë seminar (200 orë praktika aktive)
Viti akademik/semestri kur zhvillohet: 2020-2021 / Viti II , semestri III/IV
Lloji i lëndës: E detyrueshme
Programi i studimit: Master në "Mësuesi në AMU në gjuhë-letërsi"
Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: entelamaze@yahoo.com, ekashahu@gmail.com
Kodi i etikes: Pedagogu dhe studenti duhet të respektojë rigorozisht tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-së dhe të programit të studimit.

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

1-Vëzhgimet do të përqendrohen në integrimin e plotë të rubrikave: të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit. Vëzhgimet do të realizohen nga klasat e gjashta deri të nënta dhe do të punohet me librat e Gjuhës shqipe për klasat VI, VII, VIII, IX. Synim tjetër i praktikës shkollore pasive është kthimi i njohurive në shprehje e shkathtësi përmes seminareve e veçanërisht përmes seancave praktike të etapave që ndiqen përgjatë një ore mësimore.

2-Si formë e rëndësishme e organizimit të procesit mësimor në shkollën e lartë që përgatit mësues, praktika aktive ka për qëllim të aftësojë studentët nga pikëpamja profesionale për të dhënë mësim në përputhje me kërkesat bashkëkohore që shtrohen sot për forcimin cilësor të shkollës dhe për t'i aftësuar me shprehje praktike për shkollën dhe jetën. Gjithashtu, studentët duhet të pajisen me të gjitha njohuritë që ofron korniza kurrikulare për lëndën e *Gjuhës dhe letërsisë* shqipe.

3-Ndërthurja e teorisë dhe praktikës si punë mësimore dhe edukative e dhënies së mësimi letrar, rishikon dhe përmbajtjen apo sistemin e dijenive për leximin letrar dhe shprehinë në lidhje të ngushtë me njëra-tjetrën. Leximi letrar ka specifikën e vet, si një nga objektet bazë edhe të përcaktimit të lësaj lënde apo si mjet i fuqishëm dhe me vlerë edhe në letërsinë artistike. Ndërthurja e leximit me gjuhën shqipe vitet e fundit, duket se ka sjellë rediment të plotë në përcaktimin bazë të saj.

Pas përfundimit të lëndës studentët do të jetë në gjendje të:

1. Të njohin dhe të përdorin metoda, teknika e strategji bashkëkohore;
2. Ta përdorin drejtë normën drejtshqiptimore dhe drejtshkrimore të gjuhës sonë letrare;
3. Të jenë mbrojtës dhe kërkues të standardit të shqipes;
4. Të njohin dhe të zbatojnë konceptet më të rëndësishme;
5. Të njohë leximin letrar si mjet i edukimit moral dhe i formimit të botëkuptimit;
6. Të njohë çdo metodë që përdor mësuesi metodist dhe t'i praktikojë ato;
7. Të zotojë në praktikë dijenitë dhe aftësitë letrare;
8. Të vëzhgojë dhe t'i praktikojë metodat që dërgojnë në klasa të ndryshme të shkollës 9-vjeçare.



KONCEPTET THEMELORE:

- 1-Realizimi i vëzhgimeve në klasat VI, VII, VIII, IX.
- 2-Zhvillimi i shprehive të të folurit, të shkruarit, të lexuarit.
- 3-Modele teknika dhe strategji mësimdhënieje.
- 4-Struktura ERR dhe Struktura PNP.
- 5-Zvillimi i orëve mësimore nga studentët/mësues.
- 6-Pregatitja e planit ditë në përputhje me modelet e reja.
- 7-Pjesëmarrje në çdo aktivitet shkollor.
- 8-Të mësuarit me objektiva dhe kompetenca.
- 9-Mësimdhënia sipas vizionit të sotëm kurrikular.
- 10-Qëllimet e studimit të leximit letrar.
- 11-Detyrat e mësimit të leximit për zbatimin e programit.
- 12-Biseda dhe dialogu.
- 13-Analiza ideo-artistike e copave të leximit letrar në klasat e V-ta dhe të VIII-ta.
- 14-Puna jashtë klase në leximin letrar.

TEMAT E LËNDËS

Tema I: Diskutim

- Përmbajtja dhe struktura e standardeve bazë për mësuesin e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë.
- Komunikimi mësues – nxënës.

Tema II: Diskutim mbi mësimdhënien me metoda e strategji bashkëkohore

- Struktura tradicionale e orës së mësimit.
- Struktura ERR dhe Struktura PNP.

Tema III: Diskutim mbi analizën dhe përbërësit metodikë

- Pasurimi i fjalorit të nxënësve gjatë mësimdhënies.
- Përdorimi i sinonimeve, antonimeve, homonimeve dhe njësive frazeologjike.

Tema IV: Vëzhgim

- Struktura ERR dhe Struktura PNP.
- Strategji dhe ushtrime për përvetësimin e fjalëve të formuara me ndajshesa.



Tema V: Vëzhgim

- Struktura ERR dhe Struktura PNP
- Metodika e mësimit të sintaksës. Studimi i fjalisë së thjeshtë e të përbërë.

Tema VI: Vëzhgim

- Struktura ERR dhe Struktura PNP.
- Metoda të mësimitdhënies për të lexuarin

Tema VII: Vëzhgim

- Si realizohet të nxënëti?
- Vëzhgimi i orëve mësimore nga klasa e VI- IX

Tema VIII: Vëzhgim

- Dimensionet e procesit mësimor
- Objektivat didaktike dhe klasifikimi

Tema IX : Vëzhgim

- Struktura ERR dhe Struktura PNP.
- Studimi i foljes. Forma veprare dhe forma joveprare, mënyra dhe kohët e foljes.

Tema X : Vëzhgim

- Objektivat sipas niveleve, klasifikimi.
- Analizë prej secilit student.

Tema XI :Vëzhgim

- Planifikimi i mësimitdhënies.
- Përgatitja e studentëve duke u mbështetur në teknika dhe strategji.

Tema XII:Diskutim

- Modele të suksesshme mësimitdhënietje
- Mendime, metoda dhe modele për lëndën e *Gjuhës shqipe*.

Tema XIII : Vëzhgim

- Metodologjia në klasat "Hap pas hapi.
- Metodot e mendimit kritik.

Tema XIV:Analizë

- Vlerësimi i nxënësve.
- Këshilla për vlerësimin e tyre



Tema XV: Analizë

- Klima e klasave shkollore.
- Problematika të ndryshme gjatë procesit mësimor. Zgjidhja e tyre me metoda bashkëkohore

TEMAT E LËNDËS

Tema I –Mësimi letrar

Detyrat e dhënies së mësimit letrar

Objekti dhe bazat e metodikës së leximit

Teksti bazë: Namik Resuli. Shkrimtarët Shqiptarë, Tiranë, 2007, fq.11-19

Tema II. Programi dhe plani mësimor i leximit letrar

Teksti dhe struktura e hartimit të një teksti

Shembuj

Tema III. Letërsia gojore dhe e shkruar

Shembuj të sjellë në klasë

Metodika e punës jashtë klase në lëndën e leximit letrar

Tema IV.Lexim në klasë

Analizë përralla “E bukura e dheut”

Tema V: Dallimi midis tekstit biografik dhe autobiografik

Shembuj nga mësuesi i lëndës

Tema VI Çështë të folurit?

Puna për zhvillimin e të folurit.Tema e mjedisit në një kinema

Si të përshkruajmë një person, objekt apo kafshë? Dramatizimi.Pëlqyeshmëria e një vepre letrare

Mjetet figurative në këtë vepër

Tema VII: Metodika e punës jashtë klase në lëndën e leximit letrar

Kabineti i leximit letrar

Tema VIII: Analiza ideo-artistike në lëndën e leximit letrar

Shembuj.

Ç’kuptojmë me copë artistike?



Tema IX : Diskutim i lirë Diskutimi dhe gjuha e tekstit Bashkëpunimi nxënës - mësues
Tema X :Lexim Lexim dhe interpretim“Pipi Çorapegjata” (2 orë mësimore)
Tema XI Ritregim Ritregim i një përralle me fjalët tuaj por pa ndryshuar numrin simbolik dhe radhën e veprimeve (2 orë mësimore).Pjesë të shkëputura nga librat për fëmijë
Tema XII: Pëlqyeshmëria e një vepre letrare Mjetet figurative në këtë vepër
Tema XIII Çështë të folurit? Diskutim i lirë: Tema e mjedisit në një kinema Si të përshkruajmë një person, objekt apo kafshë?
Tema XIV : Teksti letrar dhe joletrar Përdorimi i tekstit në mënyrë pasive dhe aktive. Sjellje me shembuj nga nxënësit e klasës së nëntë
Tema XV: Tekstet Tekstet shkencore dhe letrare Shembuj të përkthyer nga shkrimtari Xhevahir Spahiu



FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI: Frekuentim i detyruar deri në masën 80 % të seancave të seminareve.

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Vlerësim i vazhduar dhe provim final me shkrim në përfundim të lëndës

Provimi final 80%

Vlerësim i vazhduar 20%

Vlerësimi i vazhduar do të jeteë shumatore e vlerësimit të pedagogut mbi kryerjen e detyrave si më poshtë:

- rezultatet e testeve 10 %
- aktivizimin në seancat e seminareve 10 %

Studenti rezulton kalues me minimalisht 45% të vlerësimit total apo 45 pikë.

PROVA FINALE: Provim me shkrim në fund të semestrit



LITERATURA

a) Literatura bazë e detyrueshme:

- *Gjuha shqipe*, klasa VI me autorë: Rita Petro, Natasha Pepivani, Adelina Çerpja, Mimoza Gjokutaj, Botime shkollore Albas, Tiranë, 2005
- *Gjuha shqipe*, klasa VII me autorë: Rita Petro, Idriz Metani, Adelina Çerpja, Shpresa Vreto, Botime shkollore Albas, Tiranë, 2006
- *Gjuha shqipe*, klasa VIII me autorë: Rita Petro, Idriz Metani, Adelina Çerpja, Botime shkollore Albas, Tiranë, 2007
- *Gjuha shqipe*, klasa IX me autorë: Rita Petro, Idriz Metani, Adelina Çerpja, Botime shkollore Albas, Tiranë, 2005.

b) Literatura e rekomanduar:

- Gjokutaj, M., Didaktika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2009
- Pepa, S., ; Radovicka, L. ; Dizdari, I. ; Shashaj, A. ; Dardha, Sh. Metodika e gjuhës shqipe, 1987
- Shashaj, A., Metodikë e mësimi të gjuhës amtare.
- Mërkuri, N., Teste në lëndën e gjuhës shqipe (2-5)

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS :

Studentët janë të detyruar të veprojnë në përputhje me dhe të respektojnë në menyrë rigorozë teresinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-së për t'u sjellë me integritet akademik mbështetur në ndershmërinë.

Studentet janë të detyruar :

- Të mos kopjojnë apo japin kopje në provim
- Të mos kopjojnë dhe paraqesin punën e dikujt tjetër
- Të mos fabrikojnë apo manipulojnë të dhënat
- Të respektojnë integritetin dhe dinjtetin njerëzor & profesional të personelit akademik dhe atij ndihmës
- Të respektojnë integritetin dhe dinjtetin njerëzor & profesional të studentëve të tjerë

Në rast shkeljeshe të këtyre rregullave studentët penalizohen siç parashikon rregullorja e UGJ-së dhe rregullorja e programit të studimit.



Hyrje

“Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore” merr masat e duhura për zhvillimin e praktikave mësimore/ profesionale të studentëve në programet e ciklit të parë të studimit “Bachelor”, programet e ciklit të dytë të studimit “Master”/ “Master Profesional” si dhe në programet e studimit me karakter profesional sipas modaliteteve të përshkruara qartas në secilin program studimi.

Praktikat mësimore/profesionale zhvillohen në institucionet arsimore, ndërmarrje shtetërore ose private, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogëve të caktuar nga departamenti përkatës.

Praktika parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik profesional ose t'i zhvillojë aftësitë profesionale që studentët zotërojnë si dhe t'u japë studentëve një përvojë praktike të punës në institucione, t'u krijojë mundësi për të gjetur çështje për punimin e provës finale dhe për të vendosur kontakte që do t'i ndihmojnë ata për realizimin e saj.

Secili program studimi përcakton numrin e krediteve që fiton studenti pasi merr vlerësimin përfundimtar që vërteton përmbushjen me sukses të këtij detyrimi.

I. Përshkrimi i praktikës

Praktikat mësimore/profesionale zhvillohen në institucionet arsimore, ndërmarrje shtetërore ose private, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogëve të caktuar nga departamenti përkatës. Praktika mësimore/profesionale mund të jetë vëzhguese ose praktike aktive

Praktika profesionale synon:

1. Aftësimin profesional të studentëve nëpërmjet përfshirjes në aktivitetin e institucioneve të sipërpërmendura.
2. Zhvillimin e shprehive bazë të mësimdhënies, të komunikimit, të punës në terren, të qytetarisë
3. Aftësimin e studentëve në procesin e analizës kritike, reflektimit të përvojës dhe zgjidhjes së problemeve që ngrihen në institucionet shkollore dhe joshkollore.
4. Ballafaqimin me qasje të ndryshme të organizimit të punës duke krijuar besimin për zhvillimin e një qëndrimi profesional.
5. Respektimin nga ana e studentëve të ligjshmërisë dhe etikës institucionale si dhe disiplinës në punë.
6. Përgatitjen e studentëve për njohjen dhe përshtatjen me tregun e punës



Në realizimin e këtyre synimeve një rol të rëndësishëm luan asistenca e personelit akademik përgjegjës për arritjen e objektivave të praktikës mësimore profesionale sipas përcaktimeve në programin e studimit. Elementë po aq të rëndësishëm për mbarëvajtjen e këtij komponenti të rëndësishëm janë gjithashtu mësuesit mentor të kualifikuar, mësuesit ndihmës, specialistët, drejtuesit e institucioneve arsimore, drejtuesit e ndërmarrjeve publike ose private.

Me propozim të Departamentit, Dekanati, në bashkëpunim me Rektoratin, përcakton vendet e zhvillimit të praktikës mësimore/profesionale.

Qendrat ku do të zhvillohen praktikat duhet të jenë të miratuara nga organizmat shtetërore përkatëse dhe duhet të kenë detyrime të kontraktuara me UGJ-në.

Në përfundim të praktikës studenti bën mbrojtjen e saj para pedagogëve që e udhëheqin atë, bazuar në këto komponentë përbërës:

- a. Vlerësim performance të studentit praktikant të firmosur nga drejtuesit e qendrës ku u zhvillua praktika dhe specialistët, që e udhëhoqën atë. **(Shtojca Nr 3)**
- b. Dokumente personale të zhvillimit të praktikës (planet ditare, shënimet ditore gjatë proceseve të punës etj).
- c. Vlerësimi i praktikës pasive në programet e studimit që e ofrojnë atë.

Vlerësimi bëhet me notë nga pedagogu ose pedagogët e lëndës.

Mësuesi mentor dhe anëtari i stafit akademik përgjegjës për mbarëvajtjen e praktikës mësimore profesionale do të jenë në lidhje të vazhdueshme me studentët praktikantë.

Para fillimit të praktikës profesionale nënshkruhet një marrëveshje midis studentit, mësuesit mentor/specialistit dhe pedagogut përgjegjës. **(shtojca Nr. 1)**

II. Koha e zhvillimit të praktikës

Kohëzgjatja dhe afati i praktikës mësimore/profesionale përcaktohen në planet mësimore përkatëse.

Praktika do të zhvillohet e shpërndarë gjatë kursit, gjatë një semestri ose e përqendruar në një periudhë të shkurtër kohe, sipas planit mësimor, të programit të studimit dhe sipas afateve të përcaktuara në strukturën e vitit akademik përkatës. Sasia e orëve në javë përcaktohet nga secili program studimi. Studenti njoftohet nga pedagogu përgjegjës ose përgjegjësi i njësisë bazë lidhur me kohën e zhvillimit të praktikës.



III. Praktika aktive

Për të garantuar mbarëvajtjen e këtij komponenti të rëndësishëm të planit mësimor ndiqen hapat e mëposhtme:

III.1. Masat paraprake

- Përcaktohen qendrat e zhvillimit të praktikës profesionale dhe vendosen kontaktet midis studentëve dhe institucioneve pritëse
- Studenti njihet me procedurën e praktikës profesionale (qëllimin, objektivat, përshkrimin e punës, përgjegjësitë dhe detyrimet e studentit, qëllimet e institucionit dhe pritshmërinë e palëve).
- Bazuar në procedurat e praktikës, studenti, mësuesi mentor dhe pedagogu nënshkruajnë Marrëveshjen e Praktikës. (Formati i Marrëveshjes së Praktikës i bashkëngjitet kësaj pakete).
- Studenti pajiset me paketën e praktikës mësimore/profesionale.
- Studenti njihet me dokumentacionin e detyrueshëm përbërës të paketës së praktikës mësimore/profesionale si dhe mënyrën dhe afatet e plotësimit të këtij dokumentacioni.

III.2. Gjatë praktikës

Gjatë praktikës studenti praktikant:

1. Vendos kontaktin me autoritetin e institucionit, mësuesin mentor/specialistin me përgjegjësin e stafit akademik, drejtuesit e institucionit publik ose privat.
2. Njihet me legjislacionin, misionin, objektivat, dokumentacionin dhe stafin e institucionit që kryen praktikën mësimore/profesionale.
3. Njihet me ngarkesën dhe harton planin e punës në bashkëpunim me mësuesin mentor/specialistin dhe me përgjegjësin e stafit akademik
4. Respekton në çdo hap kodin e etikës dhe legjislacionin e institucionit ku kryen praktikën.
5. Ndihmohet gjatë veprimtarisë aktive, në të gjitha hapat nga mësuesi mentor/specialisti dhe përgjegjësi i stafit akademik, drejtuesit në institucionet publike ose private.
6. Dokumenton veprimtarinë e tij të përditshme e cila do të jetë bazë për hartimin e raportit të praktikës nga studenti.
7. Merr pjesë në të gjitha aktivitetet e qendrës ku zhvillohet praktika mësimore/profesionale.
8. Harton raportin përfundimtar. (Shtojca Nr. 2).



III.3. Vlerësimi i praktikës

Në përfundim të praktikës studenti bën mbrojtjen e saj para pedagogëve që e udhëheqin atë, duke paraqitur këto dokumente:

- a. Vlerësim pune të firmosur nga drejtuesit e qendrës ku u zhvillua praktika dhe specialistët, që e udhëhoqën atë. **(Shtojca nr. 3)**
- b. Dokumente personale të zhvillimit të praktikës (raporti, planet ditarë, shënimet ditore gjatë proceseve të punës etj).
- c. Vlerësimi i praktikës pasive në ato programe që e ofrojnë atë

Pesha specifike e elementëve të mësipërm, përcaktohet nga Njësitë Bazë, duke u mbështetur në modalitetet e planit mësimor, sipas programit të studimit.

Konvertimi i pikëve në notë bëhet sipas skemës në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Sasia e pikëve	Nota
1.	1-44 pikë	nota 4
2.	45-54 pikë	nota 5
3.	55-64 pikë	nota 6
4.	65-74 pikë	nota 7
5.	75-84 pikë	nota 8
6.	85-94 pikë	nota 9
7.	95-100 pikë	nota 10

Studenti është kalues kur ai merr 45 pikë.

DEKANI

Prof.dr. Gëzim Sala





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE**

Shtojca nr. 1

MARRËVESHJA E PRAKTIKËS PROFESIONALE

Emri i studentit praktikant: _____

Programi i studimit: _____

Institucioni pritës: _____

Mbikqyrësi i institucionit: _____

Pedagogu: _____

Periudha e praktikës:

Viti akademik: _____

Semestri: _____

Fillon më datën: _____ **dhe mbaron më datën:** _____



1. Përmbledhje e praktikës profesionale:

2. Objektivat e praktikës profesionale.

3. Detyrat e studentit praktikant:

4. Produktet e praktikës (Dosja):

5. Mënyra e vlerësimit të praktikës:

STUDENTI

PEDAGOGU

**MBIKQYRËSI I
INSTITUCIONIT**

(nënshkrimi)

(nënshkrimi)

(nënshkrimi)



Shtojca nr. 2

RAPORTI I PRAKTIKËS MËSIMORE PROFESIONALE QË DO TË PËRGATITET NGA STUDENTI PRAKTIKANT

1. Të dhëna të përgjithshme

Emri i studentit/es: _____

Programi i studimit: _____

Institucioni i kryerjes së praktikës: _____

Kohëzgjatja e praktikës: _____

Emri i personit mbikëqyrës në institucion: _____

2. Përshkrimi i institucionit ku zhvillohet praktika mësimore/profesionale

- a) Misioni dhe objektivat e institucionit
- b) Struktura dhe funksionet e institucionit
- e) Veprimtaria kryesore e institucionit gjatë periudhës së praktikës

3. Përshkrimi i veprimtarisë së kryer gjatë periudhës së praktikës mësimore/profesionale.

- a) Përshkrim i përgjithshëm i punës së studentit praktikant
- b) Misioni dhe objektivat e praktikës sipas programit mësimor (syllabusi)
- c) Pritshmëritë e studentit sipas syllabuseve përkatëse
- d) Profili i praktikës së kryer
- e) Përshkrimi i aktiviteteve të kryera, gjetjet, problematikat dhe sfidat.
- f) Përvoja e fituar dhe ndikimi në zhvillimin profesional
- g) Analiza SWOT, përfundime dhe rekomandime
- k) Vlerësimi i kontributit të institucionit pritës për studentin praktikant



Shtojca Nr.3

**FORMULAR VLERËSIMI PËR ZHVILLIMIN E PRAKTIKËS
MËSIMORE/PROFESIONALE NGA STUDENTI PRAKTIKANT**

Emri i studentit/es: _____

Institucioni pranë të cilit u krye praktika: _____

Praktika nisi më _____ dhe përfundoi më _____

Emri i personit përgjegjës që mbikëqyrë praktikën: _____

(Për t'u plotësuar nga personi i cili mbikëqyrë praktikën në institucion)

Ky është një formular vlerësimi për punën e studentit gjatë praktikës. Ju lutemi vlerësojeni studentin duke vendosur numrat nga 1 në 5 (ku 5 është vlerësimi më i lartë) të cilat korrespondojnë dhe me pikët përkatëse për:

1	dobët	20 pikë
2	jo mjaftueshëm	40 pikë
3	mjaftueshëm	60 pikë
4	mirë	80 pikë
5	sh mirë	100 pikë

Për secilin tregues vendosni një X nën numrin me të cilin e vlerësoni:



Nr.	Kriteret e vlerësimit	1	2	3	4	5
1.	Frekuentimi					
2.	Respektimi i disiplinës në punë					
3.	Aftësia për t'u përshtatur me mjedisin e ri					
4.	Cilësia e punës së kryer					
5.	Aftësia për të ndërruar teorinë me praktikën					
6.	Aftësia për të ndërmarrë nisma					
7.	Aftësia për të gjykuar dhe marrë vendime					
8.	Këmbëngulja për të përfunduar detyrën e dhënë					
9.	Aftësia për të menduar dhe punuar në mënyrë të pavarur					
10.	Vëmendja ndaj detajeve					
11.	Aftësia për të kapërcyer momente të vështira					
12.	Aftësia për të zgjedhur informacionin e duhur në kryerjen e tyre punës					
13.	Aftësia për të organizuar punën në kohën e duhur					
14.	Aftësia për bashkëpunim dhe për të punuar në grup					
15.	Progresi gjatë praktikës					
16.	Aftësi për të menduar në mënyrë kritike					
17.	Aftësi komunikuese					
18.	Etika profesionale					
19.	Kompetenca digjitale					
20.	Kreativiteti					



Totali i pikëve.....

Komente: _____

Firma e vlerësuesit: _____ Data e vlerësimit: _____

Shënim: Ky formular vlerësimi, i firmosur dhe vulosur me vulën e institucionit pritës, dorëzohet i mbyllur në zarf, pranë Njësive Bazë të FESHSH, të universitetit “Eqrem Çabej” në përfundim të praktikës.

Shtojca nr. 4

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

